

LIGJ
Nr.7387, datë 8.5.1990

**PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE TË REPUBLIKËS
POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në Kodin e Procedurës Civile të RPSSH, bëhen këto ndryshime:

Neni 74 ndryshohet si vijon:

“Gjykata e rrethit shqyrton të gjitha çështjet civile.

Çështjet civile ndërmjet shtetasve për pagimin e detyrimeve deri në 1500 lekë që lindin nga kontratat ose nga shkaktimi i dëmeve, për shpërblimin e dëmeve në bujqësi deri në 1500 lekë, për zgjidhjen e martesave, për mospërmblidhjen e detyrimeve për ushqim dhe për pjesëtimin e pasurisë së lëvruar, gjykata e rrethit i shqyrton kur nuk është arritur pajtimi nga gjykata shoqërore”.

Neni 2

Në nenin 84, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për çështjet civile ndërmjet shtetasve që shqyrtohen për t’u zgjidhur me pajtim nga gjykata shoqërore, shtetasi ka të drejtë të bëjë padi, në qoftë se nuk është arritur pajtimi nga këto gjykata”.

Neni 3

Paragrafi i parë i nenit 107 ndryshohet si vijon:

“Personat që marrin pjesë në gjykim, paditësi, i padituri dhe personi i tretë, i ndjekin çështjet në gjyq vetë dhe kanë përfaqësimi. Shteti dhe këshillat popullore përfaqësohen në gjyq në mënyrën e parashikuar në ligj”.

Neni 4

Paragrafi i parë i nenit 109 ndryshohet si vijon:

“Përfaqësues të personave që marrin pjesë në gjykim, mund të jenë avokatët dhe gjithë shtetasit që kanë zotësi për të vepruar, me përjashtim të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përmbartësve gjyqësorë”.

Neni 5

Në nenin 182, pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Ministri i Drejtësisë ka të drejtë të ushtrojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të rretheve e të zonave”.

Neni 6

Nenet 135-141 të kreut VIII, si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi më 1 nëntor 1990.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA